



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Program i specializuar trajnimi në forcimin e kapaciteteve profesionale në luftimin e shpëlarjes së parave

Trajnues:

Behar Xhema

Prishtinë, 23-24 Mars, 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përmbajtja e këtij moduli është e AD-së, ndërsa pikëpamjet e autorëve nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Akademisë së Drejtësisë.

Ky material nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.

Tabela e përmbajtjes

PËRMBAJTJA

Hyrje.....	4
Objektivat trajnuese	4
Metodologjia trajnuese.....	5
Pritjet nga pjesëmarrësit.....	5
Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike.....	5
Përkufizimi i pronarit përfitues.....	5
Legjislacioni.....	7
Llojet/format e personave juridikë në Kosovë.....	7
Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme	8
Informacioni i pronësisë përfituese	8
Të kuptuarit e përdorimit të personave juridikë si dhe mjeteve dhe instrumenteve të tjera të korporatave në juridiksione të huaja	10
Personat dhe marrëveshjet juridike.....	17
Trustet	18
Krijimi i mjeteve të korporatës.....	20
Rregulla të përgjithshme	20
Rrjedha e punës së një subjekti juridik.....	21
Rrjedha e punës së trusteve	21
Ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani.....	21
Mjetet e korporatës dhe Pastrimi i Parave	22
Përdorimi abuziv i mjeteve të korporatës dhe të entiteteve të tjera me pronësi të paqartë	22
Burimet e informacionit	25
Teknikat tradicionale të hetimeve nga zbatuesit e ligjit	26
Sisteme efektive, transparente	27
Personat dhe Marrëveshjet Juridike - Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara	27
Burimet dhe literatura.....	32
Shtojca 1	33
Shtojca 2.....	34

Hyrje

Gjatë tri dekadave të fundit, konvergjenca dramatike e tregtisë globale dhe sistemeve financiare globale, si dhe rritja e internetit dhe formave të tjera të teknologjive të komunikimit, ka hapur mundësi të reja për kriminelët që të keqpërdorin strukturat e kompanive dhe biznesit për të fshehur flukset financiare anomale dhe kriminalitetin. Përtej operimit nën hije të aktiviteteve kriminale të fshehura, kriminelët maskojnë aktivitetet e tyre që të duken si tregti të ligjshme të korporatave për të fshehur fonde të paligjshme brenda një vëllimi të madh të transaksioneve që përshkojnë globin çdo ditë. Sidoqoftë, shikueshmëria nuk është e barabartë me transparencën, prandaj kriminelët përdorin një mori mjetesh, duke përfshirë kompanit guackë, trustet, marrëveshjet tjera ligjore, të emëruarit dhe ndërmjetësit profesionistë, për të fshehur qëllimin e vërtetë të veprimtarive të tyre dhe pronësinë përfituese të lidhura me to.

Qëllimet përfundimtare të çdo pastruesi të parave janë: të çaj lidhjen e dukshme midis krimit dhe përfitimit të pasurisë nga krimi; të çaj lidhjen e dukshme midis tij / saj dhe pasurisë dhe ruaj kontrollin mbi pasurinë. Mjetet korporative mund t'iu shërbejnë këtyre qëllimeve.

Pronësia dhe kontrolli i pasurive të paligjshme dhe përdorimi i strukturave ligjore për fshehjen e tyre, ka qenë objekt i vëmendjes së shtuar globale në vitet e fundit. Rrjedhja e informacionit konfidencial nga dy firma të mëdha ndërkombëtare juridike përgjegjëse për krijimin e strukturave të ndërlikuara të korporatave ndërkombëtare në 2015 dhe 2017¹ ka rritur ndërgjegjësimin e publikut për mënyrën në të cilën strukturat ligjore mund të përdoren për të fshehur pasurinë dhe pasuritë e paligjshme.

Aftësia e vendeve për të parandaluar keqpërdorimin e personave juridikë dhe rregullimet ligjore, dhe mënyrat në të cilat janë duke u keqpërdorur, ka qenë objekt i shumë dokumenteve të diskutimit dhe projekteve kërkimore gjatë dekadës së fundit ose më gjatë. Studimet janë botuar nga organe ndërkombëtare, përfshirë Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Bankën Botërore, Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), dhe Task Force për Veprimin Financiar (FATF). Përgjithësisht, këto raporte ofrojnë njohuri të pasur mbi abuzimin e strukturave të korporatave për të lehtësuar korrupsionin dhe pastrimin e parave.

Objektivat trajnuese

- Ky trajnim do t'ju ndihmojë të zgjeroni njohuritë tuaja në lidhje me:
 - *llojet e ndryshme të mjeteve të korporatave;*
 - *mënyrën e krijimit dhe regjistrimit të tyre;*
 - *Transparencën dhe pronësinë përfituese të personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike;*
 - *Për më tepër do të mësoni se si kriminelët përdorin mjetet të korporatave dhe instrumente financiare për pastrim parash;*
 - *Të kuptuarit e përdorimit të personave juridikë si dhe mjeteve dhe instrumenteve të tjera të korporatave në juridiksione të huaja;*
 - *Përdorimi abuziv i mjeteve të korporatës dhe të entiteteve të tjera me pronësi të paqartë;*
 - *Teknikat tradicionale të hetimeve nga zbatuesit e ligjit;*
 - *Pas përfundimit të suksesshëm do të ngritni njohurit tuaja për sektorin ndërkombëtar të korporatave dhe sektorin financiarë dhe si të bëni analiza të përparuar që përfshijnë mjetet e korporatave dhe produkteve financiare;*

¹ Nga Panama-based law firm Mossack Fonseca, in 2015, and Bermuda-based law firm, Appleby, in 2017.

- *Shpresojmë që ky plan mësimi të përmirësojë njohuritë dhe aftësitë tuaja dhe t'ju bëjë më të mirë në punën tuaj*

Metodologjia trajnuese

Për realizimin e trajnimit do të përdoren metoda të kombinuara trajnuese shpjegime teorike, diskutimet interaktive, studimi i rasteve praktike. Për më tepër, pas vendimeve të ndërmarra nga Qeveria e Kosovës, me qëllim të parandalimit të infeksionit Corona Virus COVID-19, është përdorë metoda online përmes platformës së mësimi në distance E-learning dhe përmes platformës elektronike Zoom.

Pritjet nga pjesëmarrësit

Pjesëmarrësit do të përfitojnë nga njohuritë e fituara lidhur me atë se si kriminelët përdorin një sërë teknikash dhe mekanizmash për të fshehur ose maskuar pronësinë e tyre dhe kontrollin e pasurive të marra në mënyrë të paligjshme.

Identifikimi i pronarit (ave) të vërtetë përfitues ose individit (ve) që ushtron kontroll paraqet një sfidë të rëndësishme për prokurorët, agjencitë e zbatimit të ligjit dhe praktikuesit e inteligjencës në të gjithë globin. Skemat e dizajnuara për të fshehur pronësinë përfituese shpesh përdorin një strategji "të fshehtë në pamje të thjeshtë", duke lejuar që infrastruktura e tregtisë globale dhe e tregtisë të duket e ligjshme.

Sidoqoftë, shikueshmëria nuk është e barabartë me transparencën, dhe shumë prej mjeteve që janë krijuar për të inkurajuar rritjen dhe zhvillimin e biznesit, siç janë korporatat apo shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar dhe shërbimet e drejtorëve të emëruar, mund të përdoren për të lehtësuar pastrimin e parave, evazionin fiskal dhe korrupsionin. Globalizimi i tregtisë dhe mjeteve të komunikimit vetëm se e ka rritur këtë kërcënim dhe vendet tani përballen me sfidën e zbatimit të ligjeve kombëtare në një mjedis tregtar pa kufij.

Rastet studimore kanë treguar që tanimë personat juridikë, kryesisht kompanitë guackë (shell), janë një nga tiparet kryesore në skemat e dizajnuara për të maskuar pronësinë përfituese, ndërsa front kompanitë dhe aksionet e bartshme, megjithëse kanë përdorim, janë më pak të shfrytëzuara krahasuar me kompanitë guackë.

Në shumë raste, pronari përfitues mban njëfarë kontrolli të drejtpërdrejtë në një skemë, por rrallëherë ndodh që ai ose ajo nuk përfshijnë në skemat e pastrimit të parave edhe ndërmjetës ose "burrë kashte" (aksionarë dhe drejtorë të emëruar joformalë, si bashkëshortët, fëmijët, etj. familja e zgjeruar, dhe bashkëpunëtorët e tjerë personal ose të biznesit).

Transparenca dhe pronësia përfituese e personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike

Përkufizimi i pronarit përfitues

Pronar Përfitues - nënkupton person fizik i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon klientin dhe/ose personin fizik në emër të të cilit është duke u kryer një transaksion apo aktivitet ose personi i cili kryesisht ushtron kontroll efektiv mbi një subjekt juridik ose marrëveshje ligjore².

² Ligji Nr. 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, neni 2

Pronari përfitues i një personi juridik është –

a. personi fizik i cili ka kontrollin e interesit të pronësisë në një person juridik; ose nëse asnjë person i tillë fizik nuk ekziston ose nuk mund të identifikohet,

b. personi fizik i cili përfundimisht kontrollon personin juridik nëpërmjet mjeteve; ose nëse asnjë person i tillë fizik nuk ekziston ose nuk mund të identifikohet,

c. personi fizik i cili mban pozitën e zyrtarit të lartë menaxhues tek personi juridik.

Në rastin e personave juridik, pronari përfitues duhet të përfshijë të paktën:

- **personin fizik** i cili ka **në pronësi ose kontrollon** përfundimisht **një subjekt juridik** nëpërmjet pronësisë ose kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të një përqindjeje të mjaftueshme të aksioneve ose të drejtave të votës në atë subjekt juridik, përfshirë edhe mbajtësit e pronësisë mbi aksionet bartëse, përveç personave juridik të regjistruar në një treg të rregulluar që u nënshtrohet rregullave të publikimit sipas standardeve ndërkombëtare të cilat sigurojnë transparencë adekuate të informacionit për pronësinë; **një përqindje prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër quhet e mjaftueshme** për të plotësuar këtë kriter; Përqindja e aksioneve prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër dhe/apo përqindja prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër e interesit në pronësi në klientin i cili zotërohet nga personi fizik do të jetë tregues i pronësisë së drejtpërdrejtë. Përqindja e aksioneve prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër ose përqindja prej njëzet e pesë perqind (25%) e më tepër e interesit në pronësi në klientin i cili zotërohet nga një person juridik i cili është nën kontrollin e personit/ve fizik, apo nga disa persona juridik të cilat janë nën kontrollin e një personi/ve fizik do të jetë një tregues i pronësisë së tërthortë;
- personin fizik i cili përndryshe ushtron kontroll në menaxhmentin e subjektit juridik.

Mbajtja e kontrollit të interesit të pronësisë në një person juridik nënkupton mbajtjen e një ose më shumë nga sa vijon –

(i) më shumë se 25% të aksioneve në një person juridik ose një interes të barasvlershëm me një pjesëmarrje prej më shumë se 25%, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në të drejtën për më shumë se 25% të pasurisë së personit juridik në rast të falimentimit të tij ose shpërbërjes,

(ii) më shumë se 25% të të drejtave të votimit në funksionimin ose menaxhimin e personit juridik

(iii) të drejtën për të emëruar ose shkarkuar drejtorë ose zyrtarë të tjerë drejtues që mbajnë shumicën e të drejtave të votimit për të gjitha ose në esencë të gjitha çështjet në mbledhjet e bordit ose në mbledhjet e personit juridik që janë ekuivalente me mbledhjet e bordit, dhe

(iv) kur personi juridik është fondacion, një interes përfitues i privilegjuar ose një e drejtë e ardhshme për të përfituar më shumë se 25% të asetëve të fondacionit

Pra kontrolli përfundimtar efektiv është aftësia e **personit (apo personave) fizik** për të marrë vendime përkatëse ose të ndikojë tek një person juridik; Personat e ndryshëm juridikë u japin kontroll figurave të ndryshme; Kontrolli gjithashtu mund të mos të jetë i lidhur me pronësinë.

Kontrolli në kompani nënkupton:

- **Aksionarët**, të cilët mund të ushtrojnë të drejtat e votimit të ndërlidhura me aksionet e tyre për të bërë ndryshime në mënyrën e funksionimit të kompanisë;
- **Bordi i Drejtorëve / Kryeshëfi ekzekutiv** të cilët zakonisht ushtrojnë një kontroll më të afërt mbi kompaninë, sipas kushteve që përcaktojnë kompetencat e tyre të kontrollit;
- **Zyrtarët ekzekutiv**, të cilët mund të ushtrojnë kontroll ditor dhe përfshihen *de facto* në transaksione dhe veprimtari të kompanisë.
- Të gjithë më lart mund të konsiderohen pronarë përfitues

Në rastin e personave juridik, pronari përfitues duhet të përfshijë të paktën të tilla si **fondacionet, trustee dhe marrëveshje ligjore** të cilat administrojnë dhe shpërndajnë fonde:

- kur përfituesit e ardhshëm janë përcaktuar tashmë, personin fizik i cili është përfitues i njëzet e pesë perqind (25%) ose më shumë të pasurisë së marrëveshjes ligjore ose subjekti juridik;
- kur individët që përfitojnë nga marrëveshja ligjore ose subjekti juridik mbeten për t'u përcaktuar, klasa e personave në interesin kryesor të të cilëve është ngritur ose funksionon marrëveshja ligjore ose subjekti juridik;
- personin fizik i cili ushtron kontroll njëzet e pesë perqind (25%) ose më tepër të pasurisë së një marrëveshje ligjore ose subjekti juridik;

Në rastet e sigurimeve të jetës apo sigurimeve të investimeve të ndërlidhura me biznes, pronarët përfitues të cilët janë të përcaktuar në mënyrë të specifikuar si person fizik, juridik apo marrëveshje ligjore apo të cilët janë të përcaktuar sipas karakteristikave apo klasave.

Legjislacioni

Përkufizimi i pronarit përfitues dhe dispozitat specifike në lidhje me identifikimin dhe verifikimin e pronarëve përfitues përfshihen në nenet 2 dhe 19 të Ligjit nr. 05/L-096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për PPP/LFT), nenet 8 dhe 10 të Rregullores së BQK-së për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja) dhe në Udhëzimin për Identifikimin e Pronarëve Përfitues.

Llojet/format e personave juridikë në Kosovë

Llojet/format e personave juridikë në vijim përcaktohen në legjislacionin e Kosovës – Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri aksionare.

Person Juridik - sipas Ligjit për Shoqërit Tregtare³ është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Shoqëria Aksionare, apo një person tjetër juridik i themeluar sipas ligjeve të aplikueshme të Kosovës apo të një shteti të huaj.

Legjislacioni i Kosovës njih edhe “shoqëritë e huaja tregtare” dhe thekson që “shoqëria e huaj tregtare mund të angazhohet në aktivitete tregtare në Kosovë, njëlloj sikurse edhe shoqëria tregtare e Kosovës, por vetëm nëse paraprakisht është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit si “shoqëri e huaj tregtare”.

Aktualisht, Regjistri i Bizneseve përmban gjithsej 161.155 shoqëri. Nga këto,

- 128.976 janë të regjistruara si Biznese Individuale,
- 3.503 si Oratakëri e Përgjithshme,
- 87 si ShKM,
- 27.061 si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK),
- 513 si Shoqëri Aksionare,
- 809 si shoqëri të huaja tregtare,
- 133 si kooperativa bujqësore,
- 30 si ndërmarrje shoqërore,
- 10 si ndërmarrje publike,
- me 33 shoqëri nën juridiksionin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit

³ LIGJI Nr. 06/L -016 PËR SHOQËRITË TREGTARE

Cenueshmëritë e pandara/ të brendshme

VKR-ja e fundit⁴ ka shqyrtuar llojet e ndryshme të personave juridikë me qëllim të vlerësimit të dobësive dhe joshjes së tyre për t'u keqpërdorur për qëllime tëPP/FT-së. Duke pasur parasysh madhësinë e ekonomisë informale dhe që shumë prej llojeve të krimit në Kosovë kryesisht gjenerojnë të ardhura në formë të parasë së gatshme, bizneset me përdorim intensiv të parave të gatshme janë të prirura për t'u keqpërdorur për PP. Përveç sektorëve tashmë të mbuluar veçmas të ndërtimit dhe të lojërave të fatit, biznese të tjera në kuadër të sektorit të shitjeve me pakicë dhe shërbimeve, p.sh. bare dhe restorante, janë të cenueshme për të funksionuar si biznese që i kombinojnë të ardhurat e paligjshme me të ardhurat nga veprimet e ligjshme, duke errësuar burimin, pronësinë dhe kontrollin e fondeve të paligjshme. Kur një kompani përdoret si mbulesë për të depozituar, lëvizur ose përdorur të ardhura të paligjshme, mund të jetë e vështirë për bankën që e mban llogarinë ta dijë se aktiviteti bankar i kompanisë përfshin pastrimin e parave.

Informatat e pasakta në lidhje me pronësinë përfituese të kompanive njihen gjerësisht si cenueshmëri të rëndësishme nga PP-ja⁵. Edhe përdorimi i kompanive guacë ose vendeve offshore konsiderohet se përdoret për pastrimin e të ardhurave të konsiderueshme që rrjedhin nga Kosova, duke qenë se Policia e Kosovës ka hetuar disa raste të lidhura me transaksionet tej-oqeanike. Megjithatë, konsiderohet si një cenueshmëri e dukshme që informacioni i pasaktë i pronësisë përfituese lejon që kompanitë në Kosovë t'i devijojnë fondet publike të lidhura me korrupsionin nga prokurimi dhe ta anashkalojnë shqyrtimin e PEP-ve nga bankat.

Përdorimi i kompanive mbulesë me pronësi të pasaktë përfituese besohet të jetë një metodë e zakonshme e PP-së që u lejon kompanive të regjistruara nga miqtë t'i kalojnë të ardhurat në kompani të tjera në pronësi të bashkëpunëtorëve të tjerë ose të afërmeve të PEP-ve.

Informacioni i pronësisë përfituese

Rekomandimi 24 i TFVF⁶-së kërkon që të dhënat e pronësisë përfituese të mbajtura brenda juridiksionit të jenë të duhurat, të sakta dhe aktuale.

Zyra e Regjistrimit e Kosovës ofron informacionin e mëposhtëm pa pagesë për publikun nëpërmjet faqes së vet të internetit (<https://arbk.rks-gov.net>):

- Lloji i personit juridik;
- Emri i personit juridik;
- Numri i regjistrimit të personit juridik;
- Data e themelimit të personit juridik;
- Adresa e personit juridik;
- Emrat e personave të autorizuar; dhe
- Emrat e pronarëve
- % e aksioneve etj

⁴ Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar në PP/FT 2018/2020

⁵ Për më shumë informacion shih <http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/FATF-Egmont-Concealment-beneficial-ownership.pdf>

⁶ Task Forca e Veprimit Financiar - FATF

Në Kosovë nuk ka ligj për trustet dhe Kosova nuk është nënshkruese e Konventës së Hagës për Ligjet e Zbatueshme për Trustet dhe Njohjen e tyre. Kjo nënkupton që as trustet as marrëveshjet e tjera juridike nuk njihen sipas ligjit të brendshëm në Kosovë. Megjithatë, nuk ka ndalim për trustet e huaja të veprojnë në Kosovë

Informacioni për krijimin e llojeve të ndryshme të personave juridikë në Kosovë është në dispozicion të publikut. Legjislacioni nuk parasheh krijimin dhe funksionimin e trusteve dhe marrëveshjeve të tjera juridikenë Kosovë. Edhe pse nuk ka ndonjë kornizë ligjore që të lejojë krijimin e marrëveshjeve juridike sipas ligjit në Kosovë, nuk ka as ndalim. Prandaj, trustet dhe marrëveshjet juridike si fondacionet, mund të regjistrohen si aksionarë të kompanive të përfshira në Kosovë, mund të kenë qasje në shërbimet e subjekteve të detyruara dhe mund të blejnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në Kosovë

Personat dhe marrëveshjet juridike duhet t'u ndalohej të keqpërdoren për pastrim parash ose financim të terrorizmit dhe informacioni për pronësinë përfituese të tyre u vihet në dispozicion pa asnjë pengesë autoriteteve kompetente

Karakteristikat e një sistemi efektiv:

Ekzistojnë masa:

- për të ndaluar që personat dhe marrëveshjet juridike të përdoren për qëllime kriminale;
- për t'i bërë mjaftueshëm transparentë personat dhe marrëveshjet juridike; dhe
- për të siguruar që të vihet në dispozicion në kohë një informacion i saktë e i përditësuar bazë dhe për pronësinë përfituese.

Informacioni bazë është publik dhe informacioni për pronësinë përfituese iu vihet në dispozicion autoriteteve përkatëse. Personat që shkelin këto masa iu nënshtrohen sanksioneve efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Kjo sjell si rezultat që personat dhe marrëveshjet juridike të mos tërheqin kriminelët për t'i keqpërdorur ato për pastrim parash dhe financim të terrorizmit.

Çështjet themelore që duhen marrë në konsideratë:

- Në ç'masë është në dispozicion të publikut informacioni për krijimin dhe llojet e personave dhe marrëveshjeve juridike në vend?
- Në ç'masë autoritetet kompetente përkatëse i identifikojnë, vlerësojnë dhe kuptojnë dobësitë dhe shkallën në të cilën personat juridikë të krijuar në vend mund të jenë ose janë duke u keqpërdorur për qëllime të PP/FT-së?
- Në ç'masë i zbaton vendi masat për parandalimin e keqpërdorimit të personave dhe marrëveshjeve juridike për qëllime të PP/FT-së?
- Në ç'masë autoritetet kompetente përkatëse mund të përftojnë në kohë informacion bazë dhe për pronësinë përfituese të të gjithë llojeve të personave juridikë të krijuar në vend që të jetë i mjaftueshëm, i saktë dhe i përditësuar?

- Në ç'masë autoritetet kompetente përkatëse mund të përftojnë në kohë informacion të mjaftueshëm, të saktë dhe të përditësuar për pronësinë përfituese të marrëveshjeve juridike?
- Në ç'masë zbatohen sanksione efektive, proporcionale dhe dekurajuese kundër personave që nuk veprojnë në përputhje me kërkesat e informacionit?

Të kuptuarit e përdorimit të personave juridikë si dhe mjeteve dhe instrumenteve të tjera të korporatave në juridiksione të huaja

Çfarë janë mjet e korporative? - OECD¹ definojnë "mjete korporative" si "persona juridikë përmes të cilave zhvillohen një larmi aktivitete tregtare, dhe ku ruhet pasuria."

Mjetet e korporatave⁷ - të tilla si kompanitë, trustet, fondacionet, ortakërit dhe llojet e tjera të personave juridikë dhe marrëveshjet — kryejnë një mori të gjerë të aktiviteteve komerciale dhe sipërmarrëse. Meghithatë, përkundër rolit thelbësor dhe legjitim që luajnë mjetet e korporatave në ekonominë globale, në kushte të caktuara, ato janë keqpërdorur për qëllime të paligjshme, përfshirë pastrimin e parave (PP), ryshfetin dhe korrupsionin, marrëveshjeve të brendshme, evazionin fiskal dhe mashtrimin të taksave, financimin e terrorizmit (TF) dhe aktivitete të tjera të paligjshme. Kjo për faktin se, për kriminelët që përpiqen të anashkalojnë masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, mjetet e korporatave janë një nga mënyrat tërheqëse për të maskuar dhe konvertuar të ardhurat e krimit para se të futen ato në sistemin financiar.

Mjetet e korporatave nënkupton gjithashtu një entitet që ndër të tjera:

- Ka të drejta dhe obligime ligjore
- Mund të hyjë në aksione
- Pagan taksat

Ato kanë aftësinë për të lidhur një kontratë me një entitet tjetër dhe zbatojnë të gjitha detyrimet kontraktuale.

Sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare në Kosovë termi Korporatë - do të thotë një Shoqëri Aksionare ose shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të regjistruar në Kosovë

Subjektet zakonisht ndahen në:

- Persona fizikë (biznese individuale)
- Personat juridikë (korporatat etj)

Person Juridik - sipas ligjit për shoqrit tregtare është Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar dhe Shoqëria Aksionare, apo një person tjetër juridik i themeluar sipas ligjeve të aplikueshme.

Përkufizimet e FATF: **Person juridik** - çdo entitet, përveç personave fizikë, që mund të krijojë një mardhënie afariste ose mund të posedoj pronën. Kjo mund të përfshijë duke mos u limituar vetëm në: shoqëritë tregtare, trustet, marrëveshjet e ngjajshme, organizata joqeveritare (OJQ) që mund të kenë forma të ndryshme që si psh. fondacione, shoqata ose shoqëri kooperative dhe subjektet e tjera përkatëse të ngjashme që kanë personalitet juridik.

Mjet i korporatave nënkupton gjithashtu një entitet që zhvillon veprimtari biznesi. Entiteti mund të

⁷ Ky term përdoret për të kuptuar personat juridikë dhe marrëveshjet ligjore, siç përcaktohet në fjalorin e Rekomandimeve të FATF

jetë:

- Subjekt juridik
- Grup i personave fizikë dhe / ose personave juridikë që bashkëpunojnë për të kryer biznes (d.m.th ortakëri)
- Person fizik (d.m.th. tregtar i vetëm ose biznes individual)
- Marrëveshja ligjore (psh: trustet)

Biznes i vetëm tregtar (Biznes Individual) - Person fizik që zhvillon veprimtari biznesi. Pasuritë private dhe ato të biznesit nuk janë të ndara. Personi fizik është përgjegjës për tërë pasurinë (asete private dhe afariste). Kanë qenë në trend në shekullin 20

Ortakëria

- Shoqërit tregtare që përfshijnë më shumë se një person, të cilët pajtohen që të bashkohen për të zhvilluar aktivitete biznesi
- Marrëveshja mund të jetë formale (bazuar në kontratë) ose joformale (bazuar në aktivitete)
- Ortakëria nuk është person juridik

1. *Ortakëria e përgjithshme (OP)* - Regjistrimi i ortakërive të përgjithshme është i zakonshëm në vendet e së drejtës civile përderisa në vendet e së drejtës zakonore kjo nuk është praktikë e këtyre endeve. Partnerët janë përgjegjës bashkërisht ose ndaras. Pronësia dhe kontrolli bëhet nga OP përveç nëse kontratat me palën e tretë (për shembull kreditorët) përcaktojnë ndryshe. Partnerët në një aranzhim të tillë zakonisht janë të lehtë për t'u identifikuar. OP dhe partnerët nuk konsiderohen se kanë ndarje individuale legale
2. *Ortakëria e kufizuar* - Regjistrimi i ortakërive të kufizuara bëhet në shumicën e vendeve të botës. Pronësi përbëhet nga së paku një ortak i përgjithshëm dhe së paku një ortak i kufizuar. Ortakëria e Kufizuar nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë e paditur në emrin e saj. Kontrolli bëhet nga nga Ortaku i Përgjithshëm i cili është përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet e Ortakërisë së Kufizuar. Ortaku i Kufizuar ka një kontroll shumë të kufizuar përndryshe Ortakëria e kufizuar mund të konsiderohet Ortakëria e përgjithshme në çështje të përgjegjësisë. Ortaku i Kufizuar mund të jetë partner investues i heshtur

Përgjegjësia:

- Ortakët e Përgjithshëm janë përgjegjës bashkërisht ose ndaras
- Ortakët e Kufizuar i kufizuar vetëm në investime

Pronësia dhe kontrolli ushtrohet nga Ortaku i Përgjithshëm përveç nëse kontratat me palën e tretë (për shembull kreditorët) përcaktojnë ndryshe. Partneriteti dhe partnerët kanë figura të ndara ligjore. Partnerët në një aranzhim të tillë zakonisht janë të lehtë për t'u identifikuar

Personat Juridik

- *Shoqëria Aksionare (Korporatat)* - Një person juridik që është inkorporuar drejtpërdrejt përmes legjislacionit ose përmes një procesi regjistrimi të krijuar me ligj.
 - Personat juridikë në të gjithë botën regjistrohen përmes një nënpunësi civil ose gjykatës.
 - Subjektet e përfshira kanë të drejta dhe detyrime ligjore që janë të dallueshme nga punonjësit dhe aksionarët e tyre dhe mund të kryejnë biznes.
 - Pronësia: përmes aksioneve
 - Përgjegjësia e kufizuar në kapitalin aksionar
 - Në disa juridiksione, bordi i drejtorit mund të jetë përgjegjës në rast të pakujdesisë së rëndë (neglizhencës)

- *Korporatat Publike & Private* –
 - Korporatat private
 - Numri i kufizuar i aksionarëve dhe transferimi i aksioneve
 - Ofrimi publik i aksioneve nuk lejohet
 - Detyrime më të pakta për raportim

 - Korporata Publike
 - Numri i pakufizuar i aksioneve dhe asnjë kufizim transferimi
 - Lejohet oferta publike e aksionit
 - Detyrimet më të rrepta të raportimit

- *Lloji i veçantë i korporatave* - Operojnë ngjashëm sikurse korporatat, por asetet janë të ndara. Kjo ndarje mund të çojë në mbrojtje të pasurive në rast të gjykimit kundër pronarit përfitues. Lloji special i korporatave janë kompanitë offshore. Kompanitë e tilla përfitojnë nga ligjet strikte të sekretit në vendin e inkorporimit. Përfaqësimi lokal bëhet nga firmat ligjore ose ofruesit e shërbimit të kompanive (aksionerët e nominuar ose drejtorët). Llojet e korporatave të tilla përfshijnë:
 - **Kompani biznesi ndërkombëtar ose korporatë biznesi ndërkombëtar (IBC)** - është një kompani offshore e formuar në bazë të ligjeve të disa juridiksioneve si një kompani neutrale tatimore e cila zakonisht është e kufizuar për sa i përket veprimtarive që mund të zhvillojë në, por jo domosdoshmërisht nga, juridiksioni në të cilin është përfshirë
 - **Kompanitë guaskë (shell)** - është një biznes që është krijuar për të mbajtur fonde në posedim dhe për të menaxhuar transaksionet financiare të një entiteti tjetër. Për dallim nga kompanitë tradicionale, kompanitë shell nuk kanë të punësuar dhe nuk tregtohen në bursë. Kompanitë Shell as nuk fitojnë para dhe as u sigurojnë klientëve produkte ose shërbime.
 - **Domiciliary Companies** - janë korporatat në bursë, të cilat janë të kontrolluara nga jashtë dhe të menaxhuara nga jashtë, kanë një zyrë të regjistruar në një vend psh: Zvicër (e cila

psh. mund të jetë në zyret e ndonjë avokatit), por nuk kanë as një prani fizike dhe as staf në atë vend psh.Zvicër.

- *Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (SHPK)* – Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e te drejtave dhe obligimeve. Një aksion në Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar është pronë personale e aksionarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tërësi. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera metë gjitha asetet e saj. Një aksionar i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar vetëm për arsye se është aksionar.

Viteve të fundit SHPK-të janë duke u bërë gjithnjë më të popullarizuara dhe po zëvendësojnë ortakëritë e përgjithshme dhe ortakëritë e kufizuara.

- SHPK-ja mund të menaxhohet qoftë nga:
 - ✓ Aksionerët të cilët menaxhojnë si të vetëm ose (bashkërisht) ose
 - ✓ Menaxhim nga Menaxheri (aksionerët zgjedhin një menaxhment)
- Marrëveshja e funksionimit midis aksionerëve përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e aksionerëve
- SHPK-ja mbron pasuritë private të aksionerëve
- Bizneset e tilla përbëjnë një strukturë hibride të biznesit midis një korporate dhe një ortakërie
- Tek SHPK-të ekzistojnë edhe fleksibilitetet tatimore / operacionale
- Në vendet e parajsave fiskale, SHPK-të kanë më pak kërkesa për zbulim dhe raportim
- Në varësi të juridiksionit, SHPK-të gjithashtu kanë kërkesa më të ulëta për kapital.
- *Fondacionet* – Një fondacion është një fond i përhershëm që themelohet dhe mirëmbahet nga kontributet për qëllime bamirësie, arsimore, fetare, kërkimore ose qëllime të tjera dashamirëse, por edhe për qëllime private (fondacione private).
 - Janë ekuivalente me Trustet e vendeve Anglosaksone (mund të përdoret për të njëjtin qëllim) dhe është një person juridik.
 - Kontrollohet nga një bord i drejtorëve
 - Nuk ka pronarë
 - Në shumicën e juridiksioneve, ato mund të jenë fondacione me përfitim publik
 - Janë shumë të rregulluara dhe zakonisht transparente

Pronarët përfitues janë:

- **Themeluesit** deri në përmasat sipas të cilave ushtrojnë kontroll mbi drejtorin ose bordin e drejtorëve;

- **Drejtori ose bordi i drejtorëve** sepse ata janë përgjegjës për vendimet e përditshme;
- **Përfituesit në rast se janë të identifikueshëm dhe të kufizuar në numër;**

Keqpërdorimi i mjeteve të korporatave mund të zvogëlohet ndjeshëm nëse informacioni në lidhje me pronarin legjitim dhe pronarin përfitues, burimin e aseteve të mjeteve të korporatës dhe aktivitetet e tij janë të disponueshme për autoritetet. Informacioni mbi pronarin përfitues dhe ligjor mund të ndihmojë zbatuesit e ligjit dhe autoritetet e tjera kompetente duke identifikuar personat fizikë që mund të jenë përgjegjës për veprimtarinë themelore, ose të cilët mund të kenë informacione përkatëse për të vazhduar një hetim. Kjo u lejon autoriteteve të "ndjekin paratë" në hetimet financiare që përfshijnë llogari / pasuri të dyshimta të mbajtura nga mjetet e korporatave. Në veçanti, informacionet e pronësisë përfituese gjithashtu mund të ndihmojnë në gjetjen e pasurive të një personi të caktuar brenda një juridiksioni. Megjithatë, vendet përballen me sfida të rëndësishme kur zbatojnë masa për të siguruar disponueshmërinë në kohë të informacionit të saktë të pronarit përfitues. Në veçanti është sfiduese kur përfshijnë persona juridikë dhe aranzhime ligjore të shtrira në juridiksione të shumta.

Task Force për Veprimin Financiar (FATF) ka krijuar standarde për transparencën, në mënyrë që të frenoj dhe parandalojë shpërdorimin e mjeteve të korporatave. Rekomandimet e FATF kërkojnë që vendet të sigurojnë që informacioni adekuat, i saktë dhe në kohë mbi pronësinë përfituese të mjeteve të korporatave është i disponueshëm dhe mund të arrihen nga autoritetet kompetente në kohën e duhur. Në masën që këto informacione vihen në dispozicion, mund të ndihmojnë institucionet financiare si dhe bizneset dhe profesionet e caktuara jo-financiare për të zbatuar kërkesat e kujdesit të duhur të klientit për mjetet e korporatave, duke përfshirë edhe identifikimin e pronarit përfitues, identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve të PP/FT, dhe të zbatojnë kontrollet e luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit bazuar në ato rreziqe (përfshirë raportimin e aktiviteteve të dyshimta dhe kërkesat e sanksioneve). Disponueshmëria e informacionit të tillë, megjithatë, nuk i përjashton institucionet financiare dhe profesionistët në fjalë nga detyrimet e tjera të tyre në bazë të legjislacionit në fuqi. Këto subjekte raportuese, në çdo rast, nuk duhet të mbështeten vetëm në informacione të tilla. Shqetësimi për keqpërdorimin e mjeteve të korporatave bëri që FATF të përforcoj dhe qartësoj më tepër standardet e transparencës. Kjo është arritur përmes rishikimit të standardeve që kishin për qëllim të sigurojnë qartësi për vendet se si të arrihet zbatimi efektiv.

Qëllimi i standardeve të FATF mbi transparencën dhe pronësinë përfituese është të parandalojë shpërdorimin e mjeteve të korporatave për pastrim parash ose financim të terrorizmit. Sidoqoftë, dihet që këto standarde të FATF ndihmojnë përpjekjet për të parandaluar dhe zbuluar kategori të tjera të caktuar të veprave penale, siç janë krimet tatimore dhe korrupsioni. Në këtë drejtim, masat që vendet zbatojnë për të përmirësuar transparencën në përputhje me Rekomandimet e FATF mund të japin një platformë për të adresuar në mënyrë më efektive shqetësimet serioze siç janë korrupsioni, si dhe për të përmbushur standardet e tjera ndërkombëtare

Një numër studimesh të rëndësishme ndërkombëtare duke përfshirë FATF, Bankën Botërore dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimet (UNODC) Iniciativa për rikthimin e aseteve të vjedhura (StAR) kanë eksploruar keqpërdorimin e mjeteve të korporatave për qëllime të paligjshme, duke përfshirë edhe keqpërdorimin e tyre për PP/FT. Në përgjithësi, mungesa e informacionit adekuat, të saktë dhe të duhur të pronësisë përfituese lehtëson pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, duke maskuar:

- identitetin e kriminelëve të njohur ose të dyshuar,
- qëllimin e vërtetë të një llogarie ose prone të mbajtur nga një mjetet e korporatës, dhe / ose
- burimin ose përdorimin e fondeve ose pronave të lidhura me mjetet e korporatave

Për shembull, informacionet e pronësisë përfituese mund të fshihen përmes përdorimit të:

- a) kompanive guaskë (shell)⁸ - (të cilat mund të themelohen me forma të ndryshme të strukturës së pronësisë), veçanërisht në rastet kur ka pronësi e huaj të cilat janë të shtrira në juridiksione të ndryshme;
- b) strukturave komplekse të pronësisë dhe kontrollit që përfshijnë shumë shtresa të aksioneve të regjistruara në emër të personave të tjerë juridikë
- c) aksioneve të mbajtësve dhe urdhrat e aksioneve të bartësve
- d) përdorimit të pakufizuar të personave juridikë si drejtorë
- e) aksionarët zyrtarë të emëruar dhe drejtorët kur identiteti i propozuesit është i paditur
- f) aksionarët dhe drejtorët e emëruar joformal, siç janë bashkëpunëtorët e ngushtë dhe familja, dhe
- g) trustet dhe marrëveshjet tjera ligjore që mundësojnë ndarjen e pronësisë ligjore dhe pronësisë përfituese të pasurive.
- h) përdorimi i ndërmjetësve në formimin e personave juridikë, përfshirë ndërmjetësit profesionistë

Këto probleme rëndohen edhe më shumë kur aspekte të ndryshme të mjeteve të korporatës implikojnë vende të shumta. Kriminelët shpesh krijojnë, administrojnë, kontrollojnë, zotërojnë dhe operojnë financiarisht me mjete të korporatave nga vende të ndryshme, duke vështirësuar punën e autoriteteve kompetente në cilindo juridiksion të marrin të gjitha informacionet e rëndësishme në lidhje me një mjet të korporatës i cili është subjekt i një hetimi për PP/FT, ose veprat e ndërlidhura penale të tilla si korrupsioni ose krimet tatimore. Në përgjithësi, mjetet e korporatave mund të krijohen me lehtësi në shumë vende, me qasje të lehtë në sistemin financiar ndërkombëtar, dhe me pronarë përfitues, truste ose ofruesit e shërbimeve të kompanive (TCSP) ose këshilltarët e tjerë profesionistë përkatës që banojnë jashtë juridiksionit ku mund të jetë krijuar mjeti i korporatës.

Strukturat shumë-juridiksionale (strukturat që përbëhen nga një seri entitetesh të korporatave dhe trusteve të krijuara në vende të ndryshme) mund të jenë të vështira për t'u gjurmuar kur transaksionet midis njësive të lidhura që duken të ligjshme përdoren për të pastruar të ardhurat

⁸ Kompanitë e guaskë konsiderohen të jenë kompani të inkorporuara që nuk kanë veprimtari të rëndësishme ose asete të lidhura

kriminale. Në raste të tilla, vonesat në marrjen e informacionit të nevojshëm në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, për të ndjekur gjurmët e parave përfundimisht dekurajojnë ose minojnë hetimin.

Kompanitë me karakteristika të caktuara gjithashtu mund të paraqesin rreziqe të larta të pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit. Kjo mund të përfshijë strukturat e kompanive që promovojnë kompleksitetin dhe rrisin vështirësinë për autoritetet për të marrë informacion të saktë të pronësisë përfituese (p.sh. kompani guaskë (Shell) dhe aksionet e bartësit) kur gjatë kryerjes së hetimeve involvohen mjetet e korporatave të dyshuar për keqpërdorim.

Trustet gjithashtu mund të përdoren për të fshehur kontrollin e pasurive, përfshirë të ardhurat e krimit. Për shembull, një Trust mund të krijohet në një juridiksion dhe të përdoret në një tjetër për të mbajtur pasuritë në juridiksione për të maskuar origjinën e të ardhurave të paligjshme. Mund të përdoret për të rritur anonimitetin duke shkëputur plotësisht pronarin përfitues nga emrat e palëve të tjera, duke përfshirë trustet, themeluesi, mbrojtësin ose përfituesin.

Mungesa e qasjes në informacionin nga zbatuesit e ligjit dhe autoriteteve të tjera kompetente lidhur me pronësisë përfituese të mjeteve të korporatave, është një pengesë e rëndësishme, për shembull kur një informacion i tillë nuk mbahet nga asnjë palë. Disponueshmëria e informacionit të pronësisë përfituese ndihmon autoritetet kompetente duke identifikuar personat fizikë që mund të jenë përgjegjës për veprimtarinë themelore në lidhje ose që kanë informacion për të vazhduar hetimin. Kjo i bën mjetet e korporatave më pak tërheqëse për kriminelët. Institucionet financiare dhe BPCJF9 gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm duke marrë informacione për pronësinë përfituese që ndihmon në parandalimin e keqpërdorimit të mjeteve të korporatës në sistemin financiar. Sidoqoftë, vendet përballen me sfida të rëndësishme kur zbatojnë masa për të siguruar disponueshmërinë e informacionit të saktë të pronarëve përfitues. Në shumë vende, informacioni mbi pronarin përfitues të një mjeti të korporatës nuk është i disponueshëm pasi nuk merret ai informacion dhe/ose nuk vërtetohet aq sa duhet në kohën kur krijohet mjeti i korporatës, duke përfshirë këtu as në fazën përgjatë ekzistencës së tij. Kjo irriton dhe dekurajon tejmase përpjekjet e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe autoriteteve tjera kompetente për të "ndjekur paratë" në hetimet financiare që përfshijnë mjetet e korporatave.

Në praktikë, skemat e sofistikuara për të pastruar të ardhurat e krimit shpesh përdorin një sërë mjeteve të ndryshme të korporatave e cila është më e komplikuar se sa thjesht përdorimi i një mjeti të vetëm korporativ. Të njëjtat parime themelore për transparencë vlejnë si për personat juridikë ashtu edhe për aranzhimet ligjore. Sidoqoftë, mënyra e zbatimit të masave mund të ndryshojë për shkak të veçorive të mjeteve të ndryshme të korporatave, dhe për këtë arsye ky trajnim do të ndajë udhëzimet në lidhje me transparencën e personave juridikë dhe atë në lidhje me marrëveshjet ligjore.

⁹ Bizneset dhe Profesionet e Caktuara Jofinanciare

Personat dhe marrëveshjet juridike

Janë trustet ekspres ose marrëveshje të tjera juridike të ngjashme. Shembuj të marrëveshjeve të tjera të ngjashme për qëllimet e PPP/LFT-së (luftimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit) përfshijnë fiducie, treuhand dhe fideicomiso.

Disa nga tiparet kryesor të mjeteve korporative janë:

- **Subjekt i veçantë juridik**, gjegjësisht janë persona juridikë të ndarë nga anëtarët ose aksionarët e tyre,
- **përgjegjësia e kufizuar**, në shumicën e rasteve, partnerët ose aksionarët janë përgjegjës vetëm për investimet e tyre, por pasuria e tyre personale nuk do të jetë e kapshme nga kreditorët e subjektit juridik.
- **Shtrirja gjeografike**, do të thotë aftësia për të vepruar jashtë vendit të regjistrimit

Informacioni për krijimin e llojeve të ndryshme të personave juridikë në Kosovë është në dispozicion të publikut. Legjislacioni nuk parasheh krijimin dhe funksionimin e trusteve dhe marrëveshjeve të tjera juridikenë Kosovë. Edhe pse nuk ka ndonjë kornizë ligjore që të lejojë krijimin e marrëveshjeve juridike sipas ligjit në Kosovë, nuk ka as ndalim. Prandaj, trustet dhe marrëveshjet juridike si fondacionet, mund të regjistrohen si aksionarë të kompanive të përfshira në Kosovë, mund të kenë qasje në shërbimet e subjekteve të detyruara dhe mund të blejnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në Kosovë.

Regjistri i Bizneseve të Kosovës (ARBK) ofron informacione pa pagesë për publikun përmes faqes së vet të internetit (<https://arbk.rks-gov.net>). Informacioni i dhënë përfshin llojin e personit juridik, emërtimin e personit juridik, bashkë me numrin e regjistrimit, datën e themelimit, adresën, emrat e personave të autorizuar dhe emrat e pronarëve. Informacioni mbi llojet dhe format e personave juridikë që mund të krijohen në Kosovë gjithashtu është në dispozicion të publikut.

Për marrëveshjet ligjore, pronësia përfituese përfshin si personat fizikë që përfitojnë nga marrëveshjet ligjore (p.sh. ndonjë përfitues individual të emëruar si përfitues apo anëtarët në një klasë të përfituesve) dhe personat fizikë që janë të lidhur me ose kanë kontroll mbi punët e marrëveshjes ligjore.

Për të identifikuar këta individë, pika fillestare duhet të jetë të kuptohet struktura e pronësisë dhe e kontrollit të marrëveshjes ligjore dhe të kërkohet nga i besuari ose zyrtari ekuivalent i një marrëveshjeje ligjore të japë detaje mbi identitetin e pronarëve përfitues të marrëveshjes ligjore.

Kjo do të përfshijë kategoritë e njerëzve si në vijim:

- çdo të besuar tjetër apo zyrtarët ekuivalentë;

- personat që kanë krijuar marrëveshjen ligjore dhe ata që fillimisht ose më vonë kanë vendosur fonde në marrëveshjen ligjore (këta njihen si themelues në rastin e trusteve);
- çdo person me kompetenca për të siguruar që çështjet e marrëveshjes ligjore janë duke u menaxhuar në përputhje me objektet e dokumenteve të saj kushtetuese dhe në një mënyrë që mbron interesat e përfituesve (këto kompetenca zakonisht krijohen vetëm në rastin e trusteve dhe mbahen nga personi i njohur si mbrojtës - protektor ose zbatues);
- çdo person me kompetencë për të:
 - emëruar apo shkarkuar ndonjë nga zyrtarët e marrëveshjes ligjore
 - drejtuar shpërndarjen e fondeve apo asetëve të marrëveshjes ligjore;
 - vendosur për investimet direkte të marrëveshjes ligjore;
 - ndryshuar aktin e trustit apo dokumentin ekuivalent; apo
 - revokuar marrëveshjen ligjore;
- çdo përfitues i identifikuar, qoftë interesat e tyre (d.m.th. të përcaktuara), që varen nga ngjarje të caktuara ose në kuadër gjykimit të zyrtarëve të marrëveshjes ligjore;
- çdo person tjetër fizik i cili ushtron kontrollin përfundimtar efektiv mbi marrëveshjen ligjore.

Pronarët përfitues gjithashtu përfshijnë ata që mbajnë ndonjë nga funksionet, kompetencat ose interesat e sipërpërmendura në mënyrë indirekte, si pronari përfitues i ndonjë personi juridik ose marrëveshjeje ligjore që i mban ato.

Në identifikimin e çdo personi që ka të ngjarë të përfitojë nga një marrëveshje ligjore, është e rëndësishme të përcaktohet nga administruesi i besuar ose zyrtari ekuivalent nëse ka persona, përveç përfituesve të identifikuar në aktin e trustit ose në dokument ekuivalent, të cilët kanë të ngjarë të përfitojnë nga trusti, për shembull, personat e përmendur në një letër të dëshirave ose dokumente të tjera të ndërlidhura.

Trustet

Trusti është **marrëveshje në mirëbesim** në të cilën **pronësia mbetet tek personi i besuar *në emër të përfituesit***¹⁰. Pra, Trusti është një marrëdhënie besimi ku njëra palë, **besuesi**, i jep një palë tjetër, **administratorit të besuar**, të drejtën për të mbajtur titujt e pronave apo pasurive për dobi të një palë të tretë, **përfituesit**.

Në truste, të gjitha subjektet mund të kualifikohen si pronarë përfitues:

Administrator i besuar, sepse ai zhvillon administrimin e përditshëm të aktivitetit që mban në besim dhe mund ta disponojë atë (megjithëse ligjërisht është i detyruar të veprojë në interes të përfituesit);

Besuesi, sepse përmes letrës së shprehjes së dëshirave, mund të drejtojë përdorimin e trustit;

Përfituesi sepse ai / ajo përfiton nga trusti (por nuk mund të ushtrojë kontroll).

¹⁰ Përkufizimi sipas Ligjit Nr. 05/L -096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit

Disa nga karakteristikat e trusteve:

- Themeluesi¹¹ është një person që transferon pronësinë e pasurive tek të besuarit me anë të një akti besimi.
- Një administrues i besuar mban asetet në fondin e mirëbesimit të ndara nga asetet e veta (llogaria e veçuar). Administratori i besuar investon dhe disponon fondet e trustit në përputhje me aktin e besimit, duke marrë parasysh letrën e dëshirave.
- Trusti është një marrëveshje ligjore dhe jo një person juridik
- Ndan pronësinë juridike nga pronësia përfituese
 - o Trustet përdoren për transferimin, mbrojtjen dhe administrimin e pasurive
 - o Atyre nuk u kërkohet të regjistrohen në shumë juridiksione
 - o Ato rregullohen nga kushtet nën të cilat janë krijuar
 - o Trustet zotërojnë asetet e transferuara tek ato
 - o Pasuritë mund të jenë në formën e parave të gatshme, sendeve personale, pasurive të patundshme, interesave të biznesit, sigurimit të jetës, aksioneve dhe obligacioneve
 - o Ata mund të marrin interesin me kalimin e kohës
 - o Ato mund të krijohen përgjatë jetës së një personi (sa personi është ende gjallë), ose pas vdekjes së specifikuar në testament
 - o Ato mund të përdoren për të shmangur pagesat e taksave dhe rregullimet ose pengesat tjera ligjore
 - o Mund të jetë i revokueshëm ose i parevokueshëm
- Trustet posedojnë ose u janë dhënë një nivel më i lartë i fshehtësisë sesa subjekteve të korporatave dhe nuk u kërkohet të regjistrohen në regjistrat qendrorë.
- Shumica e shërbimeve që krijojnë trustet ose shërbime të tjera të administratorëve të besuar janë të rregulluara.
- Shumë pak vende kanë regjistra të Trusteve siç mund të jenë regjistrat e kompanive.
- Shumë llogari rrjedhëse psh.të avokatit mund të shfrytëzohen si një pikë hyrëse e fondeve që mund të transferohen në Truste. Përdorimi i privilegjit avokat / klient dhe mjegullimi i pronarit përfitues të trusteve mund të konsiderohet si faktor nxitës për përdorimin e tyre.

Trustet kanë gjithashtu tiparet e mëposhtme¹²:

¹¹ Themeluesit janë personat fizikë ose juridikë të cilët ua transferojnë pronësinë e pasurive të tyre administratorëve të besuar nëpërmjet një akti themelimi të trustit ose një marrëveshjeje të ngjashme.

- a) pasuritë përbëjnë një fond të veçantë dhe nuk janë pjesë e pasurisë së administratorit të besuar;
- b) pronësia mbi pasuritë e trustit është në emër të administratorit të besuar ose në emër të një personi tjetër për llogari të administratorit të besuar;
- c) administratori i besuar ka kompetencat dhe detyrimin, për të cilët jep llogari, për të administruar, menaxhuar, apo disponuar pasuritë në përputhje me termat e trustit dhe detyrimet e posaçme që i cakton ligji.

Ruajtja apo rezervimi i disa të drejtave dhe kompetencave të caktuara nga themeluesi i trustit si dhe fakti që administratori i besuar mund të ketë vetë të drejta si përfitues nuk janë domosdoshmërisht në kundërshtim me ekzistencën e një trusti.

Neni 2 i Konventës së Hagës përcakton si më poshtë:

Për qëllimet e kësaj Konvente, termi "trust" i referohet marrëdhënies juridike të krijuar nga një person, themeluesi, – me akt midis të gjallëve ose për shkak të vdekjes – kur pasuritë janë vendosur nën kontrollin e një administratori të besuar (trustee) në interes të përfituesit ose për një qëllim të përcaktuar

Krijimi i mjeteve të korporatës

Rregulla të përgjithshme

Secili juridiksion ka karakterisitkat e ndryshme për themelimin e një personi juridik. Në përgjithësi, kjo përfshin:

- Kontakt me përgjegjësit shtetëror për krijimin e subjekteve në atë juridiksion - Për shërbimet e ndërmjetësimit, mund gjithashtu të përfshijë kontaktet me një profesionist ligjor
- Krijimi i një emri unik identifikues të personit juridik
- Sigurimi i një adrese të vlefshme postare ose kontakti për entitetin
- Dërgimi ose raportimi periodik ose në fazën fillestar tek një autoritet kompetent të të dhënave për:
 - ✓ Bordin e Drejtorëve
 - ✓ Strukturën e aksionerëve

¹² Konventa e Hagës për Ligjet e Zbatueshme për Trustet dhe Njohjen e tyre

Rrjedha e punës së një subjekti juridik

Shembuj të një entiteti ose subjekti juridik:

- Themeluesit zakonisht paraqiten së bashku për të krijuar një person juridik. Themeluesit mund të jenë identikë me aksionarët. Për arsye të fshehtësisë, themeluesit mund të emërohen nga aksionarët.
- Themeluesit kërkojnë mbështetje nga Trustet ose ofruesit e shërbimeve të kompanive (TCSP)
- Themeluesit / aksionari-ët paguajnë kapitalin e aksioneve (në rast korporate) në një llogari bankare të sigurt
- TCPS do të përgadisë dokumentet dhe regjistrimet e nevojshme në regjistrin e bizneseve / gjykatën ekonomike
- Regjistri i kompanive/ gjykata do të përpunojë kërkesën për themelimin e një personi juridik
- Pas miratimit, personi juridik do të regjistrohet në regjistrin e bizneseve / të dhënat gjyqësore, dhe do të fillojë të ekzistojë ligjërisht
- Fondet e bllokuara, pastaj do kalojnë në dispozicion të mjeteve të korporatave të krijuara rishtazi

Rrjedha e punës së trusteve

Themelimi i trusteve është i ndryshëm varësisht nga juridiksioni që trusti është subjekt i nënshtrimit të rregullave të atij vendi. Në përgjithësi, përfshin:

- Kontaktet me një ofrues të shërbimit të trustit dhe kompanisë në mënyrë që të:
 - Gjendet një trust
 - Vendoset struktura e trustit
 - Hartohet akti i themelimit
 - Nënshkruhet akti i themelimit të trustit
 - Transferimit të aseteve/aktiveve nga themeluesi tek administratorët e besuar të trustit

Ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani

Rekomandimet e FATF i përkufizojnë ofruesit e shërbimeve për trustet dhe kompanitë, kur përgatiten ose kryejnë transaksione për një klient, ose personat dhe bizneset të cilët ofrojnë si biznes shërbimet e mëposhtme për palët e treta:

- veprojnë si agjentë për themelimin e personave juridikë;
- veprojnë (ose marrin masa që një person tjetër të veprojë) si drejtor ose sekretar i përgjithshëm i një shoqërie tregtare, ortak në një ortakëri apo në pozicione të ngjashme në lidhje me persona juridikë të tjerë;

- ofrojnë zyrat qendrore, një adresë tregtare ose lokale për biznesin, një adresë administrative ose postare për një shoqëri tregtare, një ortakëri ose një person juridik apo marrëveshje juridike tjetër;
- veprojnë (ose marrin masa që një person tjetër të veprojë) si administrator i një trusti ekspres ose kryejnë një funksion të barasvlershëm për një formë tjetër të marrëveshjes juridike;
- veprojnë (ose marrin masa që një person tjetër të veprojë) si aksionar i emëruar i cili vepron për llogari të një personi tjetër.

Ofruesite shërbimeve për truste dhe kompani – Paragrafi 1.8 i nenit 16 të Ligjit për PPP/LFT-në përcakton ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani që nuk mbulohen diku tjetër në Ligjin për PPP/LFT-në si subjekte raportuese në bazë të ligjit kur ato u ofrojnë shërbimet e lartpërmendura palëve të treta në baza tregtare.

Disa nga shërbimet që ofrojnë ofruesit e shërbimeve për trustet dhe kompanitë janë:

- Inkorporimet ekzistuese
- Aksionarët dhe drejtorët e Emëruar
- Një zyrë vendase regjistrimi
- Një zyrë me emër dhe poste për korrespondencë
- Procesverbalet e mbledhjeve nga Bordi fillestar i Drejtorëve dhe Takimet Vjetore të Aksionarëve
- Shërbime virtuale të zyrës si:
 - Adresa e zyrës
 - Numrat e telefonit dhe faksit (dhe ndokush për t'iu përgjigjur atyre)
 - Shërbimet e dërgimit të postës anonime
 - Do ta raportojë biznesin si mbajtje të një llogarie qendrore, ndërsa 'biznesi' në të vërtetë drejton fonde përmes llogarive të tjera.Mjetet e korporatës dhe Pastrimi i Parave

Përdorimi abuziv i mjeteve të korporatës dhe të entiteteve të tjera me pronësi të paqartë

- Fshehja e identitetit
- Mjetet e korporatave në juridiksione të huaja
- Përdorimi i kompanive guaskë - Shell dhe Shefl kompanitë
- Juridiksonet e shumfishta

Qëllimi i pastrimit të parave është të fshehë fitimet e paligjshme në mënyrë që ato të jenë në gjendje të "pastrohen" dhe të përdoren në të ardhmen.

Mjetet e korporatave ofrojnë një rrugë për:

- Mbledhjen e të ardhurave nga kryerja e një vepre të ndërlidhur penale
- Shtresimin, fshehjen dhe përzirjen e fitimeve të jashtligjshme
- Integrimin e fitimeve në ekonominë e ligjshme
- Kontrollimin e pasurive të fituara përmes krimit
- Ndarjen e lidhjes midis autorit të krimit + veprës penale dhe parave
- Kryerjen e aktiviteteve financiar të mbuluar/mbështjell me fshehtësi

Si pengohen autoritetet e zbatimit të ligjit gjatë hetimeve të rasteve të PP/FT ose veprave të ndërlidhura?

Informacionet e rëndësishme për pronarin përfitues mund të fshihen apo fshehja identitetit pas dikujt tjetër bëhet përmes:

1. Mjeteve të korporatës:

- *kompanive guaskë (shell companies)* të cilat mund të themelohen me forma të ndryshme të strukturës së pronësisë, veçanërisht në rastet kur ka pronësi të huaj e cila është e shtrirë në juridiksione të ndryshme. Kompania shell (guaskë) nënkupton një kompani e themeluar pa operacione të pavarura, pa asete të rëndësishme, pa aktivitete biznesi në vazhdim ose pa punonjës. Duket jo ilegale për nga përkufizimi. Shërben si mjet për transaksione financiare ose afariste pa pasur nevoj të mbaj asete ose kryerjen e operacioneve. Ndryshe njihet edhe si rrjet global i “Offshore”¹³. Kompanitë guaskë mund të përdoren në mënyrë të ligjshme dhe të paligjshme
 - *kompania front (para kompania)* - kompani plotësisht funksionale me karakteristikat e një biznesi të ligjshëm, e cila shërben për të maskuar dhe errësuar veprimtarinë e paligjshme financiare
 - *Kompanive shelf* – e cila nënkupton një kompani e themeluar me aksionarë, drejtorë dhe sekretar pasivë dhe e cila lihet pasive për një periudhë të gjatë edhe nëse tashmë është krijuar një marrëdhënie klientësh. Pra, kompanit shelf janë kompani të regjistruara që nuk kanë aktivitete, kanë aksionarë dhe drejtorë joaktivë, dhe qëndrojnë të fjetura. Këto kompani iu shiten individëve të interesuar në kompani të cilët ekzistojnë për një kohë të gjatë. Për nga përkufizimi nuk duket e jashtligjshme. Zakonisht regjistrohet nga TCSP¹⁴ ose autoriteti ligjor.
1. Të nominuarve (emëruarve) - aksionet që mbahen nga një i emëruar në emër të një personi tjetër duhet të trajtohen se i përkasin atij personi tjetër, e jo të emëruarit.
- *emërimi formal i aksionarëve dhe drejtorëve*, ku identiteti i propozuesit është i panjohur;

¹³ Parajsa fiskale

¹⁴ Ofruesit e shërbimeve për truste dhe kompani

- *emërimi jo formal i aksionarëve dhe drejtorëve, siç janë bashkëpunëtorët e ngushtë dhe familjarët. Drejtorët dhe aksionarët e emëruar, posaçërisht të emëruarit joformal, janë një cenueshmëri kryesore.*
 - *Pronësia indirekte përmes të emëruarve do të ekzistojë kur një individ (emëruesi) emëron një palë tjetër (të emëruarin) për të mbajtur aksione apo të drejta në një person juridik në emër të tij. I emëruari do të regjistrohet në regjistrin e aksioneve ose në dokumente të tjera zyrtare të personit juridik si mbajtës i aksioneve ose të drejtave në fjalë dhe identiteti i emëruesit nuk do të zbulohet. I emëruari mund të jetë një subjekt (shpesh ofruer i shërbimeve të korporatave) ose një person fizik, zakonisht një anëtar i familjes, mik ose bashkëpunëtor i emëruesit. Ndonëse shpesh ka arsye legjitime për përdorimin e aksionarëve të emëruar, kjo mund të ofrojë gjithashtu një mjet për të fshehur pronësinë dhe kontrollin përfundimtar të një personi juridik. Për shembull, një person fizik mund të mbajë në mënyrë indirekte një interes të shumicës në personin juridik nëpërmjet përdorimit të aksionarëve të emëruar ose personave pa integritet ku secili ka një interes minimal dhe në këtë mënyrë fshehet identiteti i personit fizik i cili aktualisht mban kontroll efektiv.*
 - *Edhe pse marrëdhëniet e të emëruarve janë të ndryshme nga situata ku një person kontrollon ushtrimin e të drejtave të mbajtura nga një tjetër ose ushtron kontroll me mjete të tjera, në praktikë mund të ketë një shkallë të mbivendosjes në disa raste. Në mënyrë të ngjashme, kur një i emëruar është një subjekt, mund të ketë gjithashtu mbivendosje me situatën e shqyrtuar më poshtë në lidhje me zinxhirët e pronësisë.*
 - *Roli i të emëruarit, në shumë raste, është të mbrojë ose të fshehtë identitetin e pronarit dhe kontrolluesit përfitues të një kompanie ose pasurie.*
 - *Një i nominuar mund të ndihmojë të tejkalohen kontrollet juridiksionale mbi pronësinë e kompanisë dhe të anashkalojë ndalesat e drejtimit të përcaktuara nga gjykatat dhe autoritetet qeveritare.*
 - *Emërimi i të nominuarve është i ligjshëm në shumicën e vendeve, por përfaqëson një cenueshmëri të rëndësishme për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit*
 - *Kjo ilustron me shembujt në shtojcën 1*
2. *Aksioneve të mbajtësit (bartshme) dhe garancionet e aksioneve bartëse - Aksionet e mbajtësit u referohen instrumenteve të negociueshme që i japin pronësinë e personit juridik personit që posedon certifikatën e aksioneve të mbajtësit. Ky lloj është një dobësi aq e madhe për pastrimin e parave, sa që shumica e vendeve morën masa për të kufizuar përdorimin e tyre.*
 3. *Institucionet financiare - përdorimi i individëve dhe instrumenteve financiare për të errësuar marrëdhëniet midis pronarit përfitues dhe aseteve, përfshirë aksionet bartëse, të emëruarit dhe ndërmjetësit profesional*
 4. *Të ndryshme*

- *strukturave komplekse të pronësisë dhe kontrollit* që përfshijnë shumë shtresa të aksioneve të regjistruara në emër të personave të tjerë juridikë. Një metodë kryesore që përdoret për të maskuar pronësinë përfituese përfshin përdorimin e shumë personave dhe rregullimeve juridike. Shtimi i shtresave të shumta të pronësisë ndërmjet një pasurie dhe pronarit përfitues në juridiksione të ndryshme, dhe përdorimi i llojeve të ndryshme të strukturave juridike, mund të parandalojnë zbulimin dhe të çrregullojnë hetimet;
- *përdorimi i pakufizuar i personave juridikë si drejtorë;*
- *trustet dhe marrëveshjet e tjera ligjore* që mundësojnë ndarjen e pronësisë ligjore dhe pronësisë përfituese të aksioneve;
- *përdorimi i ndërmjetësve* në krijimin e personave juridikë, përfshirë ndërmjetësit profesionistë;
- *krijimi i strukturave komplekse të pronësisë dhe kontrollit* përmes përdorimit të personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike, veçanërisht kur krijohen në juridiksione të huaja;
- *falsifikimin e veprimtarive* përmes përdorimit të kredive të rreme, faturave të rreme si dhe ndërhyrje në kodet burimore kompjuterike të pagesave.

Burimet e informacionit

Regjistrat e bizneseve: duhet të regjistrojnë dhe të ruajnë informacionin bazë për një kompani, përfshirë emrin e kompanisë, dëshminë e regjistrimit, formën dhe statusin ligjor, adresën e zyrës së regjistruar, kompetencat themelore rregulluese dhe listën e drejtorëve.

Edhe pse regjistrat e kompanive janë burimi i parë i informacionit, ekzistojnë kufij që duhet të merren parasysh:

- nuk mund të verifikojnë nëse informacionet që pranojnë janë të sakta.
- nuk janë të detyruar të kryejnë aktivitete të PPP / LFT.
- mund të ketë sanksione të pamjaftueshme për informata të humbura / të pasakta / të rrejshme.
- në shumicën e vendeve ato nuk japin informata rreth UBO¹⁵ (pronarit të fundit përfitues)

Burime të tjera të informatave:

- Institucionet bankare dhe financiare (deri në përmasa që u lejohet të shkëmbejnë informata me një subjekt tjetër përveç autoriteteve kompetente)
- Baza komerciale të të dhënave;
- Raportet e mediave;
- Burimet e hapura si Google ose programet tjera për kërkim;
- Hartat në internet dhe pamjet e nivelit të rrugës:

Duke analizuar vendndodhjen e një adrese të dhënë nga një klient ose kompani, si dhe pamja fizike e asaj adrese nga rruga (ku figurat janë të disponueshme), shpesh është e mundur të identifikohen anomalitë që tregojnë për një kompani shell ose një përpjekje për të fshehur identiteti i vërtetë i klientit.

¹⁵ Ultimate Beneficial Owner

Anomalitë mund të përfshijnë:

- ✓ lokacioni nuk është në përputhje me profilin financiar të klientit;
- ✓ lokacioni nuk është në përputhje me profilin e biznesit të kompanisë;
- ✓ pamja fizike e adresës është në kundërshtim me madhësinë dhe natyrën e kompanisë
- ✓ adresa është një kuti postare.

Për adresat që duken jonormale mund të nevojitet kujdes i shtuar dhe monitorim më i afërt.

Mekanizmi në dispozicion të autoriteteve kompetente:

Ndihma juridike reciproke - është gurthemeli i shumicës së hetimeve kryesore që përfshijnë strukturë transnacionale të korporatave apo rrjedhat ndërkombëtare financiare.

Mirëpo, shumë agjenci të zbatimit të ligjit dhe inteligjencës kanë raportuar vonesa në kërkesat të ndihmës juridike reciproke.

Është një instrument i çmuar dhe përdorimi i tij duhet të inkurajohet.

Shpalosjet dhe shkëmbimi i inteligjencës - Përveç ndihmës juridike reciproke, e cila shpesh përdoret për të shkëmbyer informacione për qëllime të sigurimit të provave, NJIF dhe autoritetet kompetente do të shkëmbejnë rregullisht informacione me partnerët ndërkombëtarë vetëm për qëllime të inteligjencës. Këto shkëmbime të inteligjencës mund të jenë spontane ose me anë të kërkesës dhe mund t'u ndihmojnë shumë NJIF-ve për të kuptuar pronësinë dhe kontrollin e strukturave komplekse ndërkombëtare, ose aktivitetet financiare të atyre strukturave.

Baza e të dhënave tatimore - Baza e të dhënave tatimore është një mjet i dobishëm për të identifikuar treguesit e kriminalitetit dhe të skemave që synojnë të mjeçullojnë pronësinë përfituese. Duke krahasuar vlerësimet e mëparshme tatimore me pasqyrat bankare, transaksionet financiare, pasurinë dhe stilin e jetës së një individi, është e mundur të identifikohen aktivitete jonormale financiare.

Hetimi i mëtutjeshëm shpesh zbulon struktura të dyshimta kontrolli ose veprime korporative që synojnë të fshehin pronësinë përfituese.

Baza e të dhënave të deklarimit të pasurisë - Shumë vende kërkojnë që zyrtarët publikë të deklarojnë publikisht pasuritë e tyre në bazat e të dhënave që janë publikisht në dispozicion. Këto baza të të dhënave mund të jenë një mjet i dobishëm për të vlerësuar pasurinë dhe pronat e zyrtarëve publikë dhe mund të ndihmojnë në identifikimin e aktiviteteve jonormale financiare. Për më tepër, mungesa e një pasurie, e cila qartazi kontrollohet nga zyrtari, familja e tyre ose interesat e tyre korporative nga regjistri mund të jetë një tregues i përpjekjeve për të fshehur pronësinë e tyre mbi këtë pasuri.

Teknikat tradicionale të hetimeve nga zbatuesit e ligjit

Mbikëqyrje e fshehtë: përfshirë përgjimin telekomunikues dhe vëzhgimin fizik. Këto teknika mund të përdoren për të identifikuar lidhjet midis bashkëpunëtorëve dhe për të identifikuar kontrollin mbi pasuritë ose kompanitë.

Informatorët dhe dëshmitarët: ish bashkëshorti, ish partneri, ish punonjësit dhe punonjësit aktual, konkurrentët dhe klientët mund të jenë një burim tepër i vlefshëm i informatave;

Mandatet për bastisje: shumë e dobishme për të siguruar marrëveshje konfidenciale, kontrata, korrespondencë, email, shënime.

IP Adresat: Duke qenë se shumica e transaksioneve financiare tash po realizohen përmes internetit, mbledhja e informatave rreth IP adresave mund të sigurojë një pasqyrë të vlefshme se kush është duke porositur një transaksion, dhe nga ku është duke u porositur ai transaksion

Sisteme efektive, transparente

Cilat janë atributet që çojnë në një sistem efektiv, transparent?

- Mungesa e qasjes së gjerë në fshehtësinë bankare
- Qartësim se çfarë është e mbuluar nën privilegjin e avokat/klient
- Identifikimi i personave fizikë që zotërojnë dhe / ose kontrollojnë, përfitojnë nga entiteti, në emër të të cilëve kryhet transaksioni
 - Kur krijohet një person juridik
 - Hapja e llogarive etj.
 - Shmangia e aksionarëve / drejtorëve të emëruar
- Kërkimi përmes regjistrave që përmbajnë:
 - Emri i entitetit, lloji, statusi dhe data e krijimit
 - Adresa e vendit burimor të biznesit (pa kuti)
 - Detaje të individëve në kontrollet formale (d.m.th. drejtorë, pronarë përfitues, partnerë etj.) me adresë, kombësi dhe ditëlindje
 - Paraqitjet historike dhe kthimet vjetore
 - Aksionarë / pronarë kryesorë
 - Emri i një personi fizik që mund të mbahet përgjegjës në rast abuzimi nga entiteti
- Identifikimi i kompanive shelf
- Kryesisht në përputhshmëri standardet e FATF dhe udhëzimet Egmont
- Marrëveshje për shkëmbimin e informacionit dhe forma të tjera të bashkëpunimit të ndërsjellë
- Sigurimi që TCSP-të të jenë të mbuluara nga legjislacioni kombëtar për PPP/ LFT

Personat dhe Marrëveshjet Juridike - Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Në kuadër të asistencës teknike të ofruar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian nën PECK, Kosova i është nënshtruar vlerësimit të pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare në luftimin e

pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Rezultatet e këtij vlerësimi janë finalizuar dhe miratuar në dhjetor 2018.

Raporti i Vlerësimit pranon se, që nga vlerësimi i ciklit të parë (2012-2014), Kosova ka ndërmarrë masa për ta përmirësuar pajtueshmërinë teknike dhe efektivitetin e kornizës së saj LPP/LFT.

Në të njëjtën kohë, një numër i boshllëqeve substanciale nuk ishin adresuar, veçanërisht nga mungesa e një kornize legjislative dhe institucionale për implementimin e sanksioneve financiare të synuara, transparencën e personave juridikë dhe masat e kontrollit në lidhje me organizatat jofitimprurëse (OJQ).

Për t'u marrë me boshllëqet e lartpërmendura dhe për ta përmirësuar më tej sistemin LPP në Kosovë, Raporti i Vlerësimit jep një numër të rekomandimeve nën të gjitha 11 rezultatet e menjëhershme që përdoren për vlerësimin e efektivitetit nga Metodologjia për Vlerësimin e pajtueshmërisë teknike me rekomandimet e FATF dhe Efektivitetin e sistemeve LPP/ LFT (në testin e mëtejshëm "Metodologjia FATF").

Andaj, ky trajnim ka për fokus fuqizimin e aftësive për identifikimin e pronësisë përfituese dhe për të kufizuar keqpërdorimin e personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike për qëllime të PP/FT (Personat dhe marrëveshjet juridike). Po ashtu, janë prezantuar edhe gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara për bashkëpunimin ndërkombëtar.

Më poshtë janë prezantuar gjetjet kryesore dhe rekomandimet e dala nga raporti i vlerësimit të përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit.

Gjetjet kryesore dhe veprimet e rekomanduara

Gjetjet kryesore

- Sipas ligjeve të Kosovës, të gjithë personat juridikë duhet të regjistrohen. Informacioni bazë është i disponueshëm publikisht përmes Regjistrimit të Bizneseve (ARBK) dhe si i tillë, është transparent. Edhe pse nuk ka një regjistër të mirëfilltë të pronësisë përfituese, bankat dhe institucionet financiare duket se janë përgjithësisht të vetëdijshme për nevojën që të identifikojnë pronarin përfitues të një subjekti juridik ose marrëveshjeje, megjithatë, të kuptuarit e asaj që përbën pronësi përfituese ndryshon. Për më tepër, në raste të caktuara shërbimet ende ofrohen nëse pronari përfundimtar fshihet pas strukturave komplekse.
- Nuk duket të ketë ndonjë proces për verifikimin e informacionit që i ofrohet Regjistrimit të Bizneseve apo për të kontrolluar nëse informacioni duhet të përditësohet. Përderisa ekziston kërkesë ligjore për ndryshimin e informacionit bazë në lidhje me të gjithë personat juridikë që duhet të raportohen në Regjistrimin e Bizneseve brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga ndryshimet e bëra, mosrespektimi nuk i nënshtrohet asnjë ndëshkimi. Megjithatë, përshtatshmëria, saktësia dhe aktualiteti i pjesës më të madhe të informacionit në regjistër duket të jenë të kënaqshme.
- Autoritetet nuk i kanë vlerësuar rreziqet e PP/FT-së lidhur me llojet e personave juridikë të krijuar në Kosovë. Për më tepër, përdorimi i mundshëm i ndërmjetësuesve

mashtuesdhe përdorimi i paligjshëm i të emëruarve nuk janë hulumtuar mjaftueshëm dhe haset nëshumë pak vlerësim tërreziqeve të paraqitura nga këto dukuri.

- Kosova përdor mekanizma bazë për t'u siguruar se informacioni për pronësinë përfituese është i saktë dhe i përditësuar. Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe NjIF-i përdorin informacionin ekzistues të siguruar nga bankat sipas kërkesave të tyre të KDK-së. Meqë ka pasur shumë pak hetime që përfshijnë përdorimin e personave juridikë dhe nevojën për të marrë informacion mbi pronësinë përfituese, Policia e Kosovës dukej se nuk kishte njohuri nëse në raste të tilla ata do të ishin në gjendje të merrnin informata të përshtatshme, të sakta dhe aktuale përtej informacionit në dispozicion në Regjistrin e Bizneseve dhe prej kujt do të ishin në gjendje t'i siguronin ato.
- Informacioni për pronësinë përfituese në përgjithësi mbahet nga bankat, edhe pse është shumë e dyshimtë nëse institucionet e tjera financiare dhe BPCJF të jenë në dijeni të këtij detyrimi. Bankat kryesisht mbështeten në Regjistrine Bizneseve për informacionembi aksionarët, e megjithatë, me përjashtim të bankave që janë filiale të grupeve më të mëdha, shumë pak siguri është dhënë sa i përket rastit të klientëve të shoqërive tregtare të përfshira në juridiksione të huaja se a ka njohuri se si të marrin informacion mbi pronësinë përfituese dhe si të konstatohet se informacioni i dhënë është i vërtetë. Mbështetja ndonjëherë kryhet mbi bazën e deklaratave të bëra nga klientët dhe ky modalitet ngre çështje që lidhen me mungesën e saktësisë dhe vërtetësisë së informacionit të mbledhur.
- Gjatë punës së vet mbikëqyrëse, BQK-ja vlerëson nivelin e verifikimit të informacionit mbi pronësinë përfituese nga subjektet raportuese ndërkohë që zhvillon inspektime në terren. BQK-ja kontrollon nëse ai është i përshtatshëm, i saktë dhe aktual. Efektiviteti i kornizës së sanksioneve të BQK-së është i diskutueshëm sikurse edhe efekti zbindësisanksioneve. Edhe pse ka pasur zbrazëti të rastit që janë identifikuar lidhur me pronësinë përfituese, asnjë gjobë nuk është vënë ndonjëherë.
- Duket të ketë të kuptuar shumë të kufizuar të rreziqeve të paraqitura nga personat juridikë dhe marrëveshjet juridike. Autoritetet nuk duket të vlerësojnë se çdo vend përballet me rrezikun e pronësisë indirekte të personave juridikë dhe marrëveshjeve juridike përmes strukturave komplekse dhe se mund të ketë interes në investimin e fondeve të paligjshme përmes subjekteve të shoqërive tregtare të përfshira në një vend tjetër. Ata as nuk kanë njohuri të mjaftueshme për mekanizmat me anë të të cilëve marrëveshje juridike si trustet dhe fondacionet mund të krijohen në një vend të huaj dhe të përdoren për të vepruar brenda territorit të një juridiksioni tjetër. Në të vërtetë, autoriteti i vetëm që gjatë pjesës së vlerësimit në terren ka demonstruar nivel të dukshëm të kuptuarit të konceptit të kontrollit që ushtrohet nga një palë e tretë që nuk është zyrtarisht pronar i një personi juridik, ishte Administrata Tatimore e Kosovës.
- Sektori financiar dhe BPCJF-të po ashtu nuk e vlerësojnë mjaftueshëm faktin se edhe pse shumica e klientëve të tyre janë vendas, është shumë e mundur që pronësia të fshihet nëpërmjet strukturave komplekse dhe përdorimit të të emëruarve. Dështimi për ta vlerësuar këtë rrezik i ekspozon ata ndaj të qenit të përdorur padashur për qëllime tëPP/FT-së.
- Korniza ligjore në Kosovë nuk i njeh trustet, edhe pse funksionimi i marrëveshjeve juridike të përcaktuara sipas ligjit të huaj nuk ndalohet. Ekipi i vlerësimit nuk është bindur se autoritetet apo subjektet raportuese kanë njohuri të duhura për rreziqet e PP/FT-së që lidhen me marrëveshjet juridike pasi që ata nuk kanë njohuri të mjaftueshme të

strukturave të tyre dhe natyrës së aktiviteteve të tyre.

Veprimet e rekomanduara

Kosova duhet të ndërmarrë masa për të fuqizuar aftësinë e saj për identifikim të pronësisë përfituese dhe për të kufizuar keqpërdorimin e personave juridikë dhëmarrëveshjeve juridike për qëllimet PP/FT-së të tilla si:

- Kryerja e një vlerësimi të rrezikut në nivel vendor që shqyrton llojet e ndryshme të personave juridikë me qëllim vlerësimin e dobësive dhe tërheqjes të tyre për t'u keqpërdorur për qëllime të PP/FT-së;
- Përfshirja e një ndëshkimi administrativ që mund të vendoset për mosnjohim të ARBK-së lidhur me ndryshimet në zotërimin e aksioneve;
- Rritja e nivelit të mbikëqyrjes dhe numrit të inspektimeve në terren, sidomos në lidhje me sektorin e BPCJF-ve, për të siguruar, ndër të tjera, që informacioni i pronësisë përfituese po mblihet dhe mirëmbahet;
- Vendosja e sanksioneve administrative zhbindëse, efektive dhe proporcionale si në sektorin financiar, ashtu edhe në sektorët e BPCJF-ve sa herë që identifikohen shkelje në lidhje me detyrimin për të mbajtur informacion mbi pronësinë përfituese;
- Rritja e nivelit të vetëdijesimit brenda Policisë së Kosovës për mënyrën se si personat juridikë dhe marrëveshjet juridike mund të përdoren për qëllime të PP-së dhe FT-së, për mënyrën se si mund të krijohen marrëveshje juridikenë juridiksione të huaja dhe si ato mund të veprojnë në Kosovë dhe nevojën për të siguruar qasje në të dhënat e pronësisë përfituese me qëllim të ndjekjes së hetimeve vendore dhe për t'ia dhënë këtë informacion homologëve të huaj kur bëhet kërkesa për informacion.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjetjet kryesore

- Pavarësisht përpjekjeve të rëndësishme të AZL-ve për shkëmbim të informacionit ndërkombëtar, nuk u demonstrua mjaftueshëm se ato përqendrohen si duhet në rastet e PP-së dhe FT-së. Bashkëpunimi mbikëqyrës në këtë drejtim duket të jetë i kufizuar.
- Mangësitë e përgjithshme lidhur me qasjen në informacionin për pronësinë përfituese ndikojnë edhe në bashkëpunimin ndërkombëtar.

Veprimet e rekomanduara


- AZL-të e Kosovës duhet të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar në mënyrë proaktive për të siguruar se të gjitha rastet e mundshme të PP-së dhe FT-së eksplorojnë si duhet.
- Duhet të organizohet rregullisht trajnim i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm për të gjitha autoritetet hetuese të Kosovës se si të kërkojnë dhe të përdorin ndihmën juridike ndërkombëtare.

Burimet dhe literatura

- Ligji 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit,
- Raporti i Vlerësimit të përputhshmërisë së Kosovës me standardet ndërkombëtare në parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimine financimit të terrorizmit.
- Raporti i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë,
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023
- DOKUMENT TEKNIK - Rekomandimet për Transparencën e Pronësisë Përfituese si Përgjigje ndaj Raportit të Vlerësimit për Kosovën (PECK II)
- Rekomandimet e FATF - standardet ndërkombëtare mbi pastrimin e parave luftimin dhe financimin e terrorizmit
- FATF guidance - TRANSPARENCY AND BENEFICIAL OWNERSHIP
<https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/Guidance-transparency-beneficial-ownership.pdf>
- FATF-Egmont Group: Fshehja e pronësisë përfituese, 2018
<https://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/reports/FATF-Egmont-Concealment-beneficial-ownership.pdf>


Shtojca 1

Shembulli 1



Në figurën 4, F Co është një kompani e huaj në të cilën A mban 40% të aksioneve dhe B dhe C secili mbajnë 20% të aksioneve. Mbajtja e më shumë se 20% të aksioneve mund të ketë pasoja tatimore për C në juridiksionin në vendin e tij. Prandaj C emëron D, një ofrues i shërbimeve korporative, që të mbajë 20% të aksioneve si i emëruar i tij. Pasi që A mban më shumë se 25% të aksioneve në F Co, A është pronari përfitues i F Co. B mban më pak se 25% të aksioneve në F Co kështu që nuk është pronar përfitues i F Co. Edhe pse C mban vetëm 20% të aksioneve në emrin e tij, D mban edhe 20% të aksioneve si i emëruar i C-së. Meqenëse aksionet e mbajtura nga një individ në emër të një individi tjetër duhet të trajtohen për qëllime regjistrimi që i përkasin atij individi, aksionet e D-së duhet të trajtohen që i përkasin C-së, jo D-së. Kjo do të thotë se C mban më shumë se 25% të aksioneve në total kështu që C është një pronar përfitues i F Co.

Shembulli 2



Në figurën 5, K Co është një kompani e themeluar nga A, një biznesmen ndërkombëtar, për të mbajtur pasurinë e tij. Pasi që A shpesh udhëton për biznes dhe e ka të vështirë të marrë pjesë në mbledhjet e aksionarëve ose për t'u marrë me administrimin e K Co, ai transferon të gjitha aksionet në K Co tek B, vëllai i tij, në mënyrë që ai të mund të merret me punët e përditshme në drejtimin e K Co në emër të tij. Pasi që B mban aksione në emër të A, aksionet e tij duhet të trajtohen se i përkasin A-së, e jo atij. Kjo do të thotë se A është pronar përfitues i F Co